



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2

Dhjetor 2024

ASISTENTËT E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË PRAKTIKËN LIGJORE: RITJA E PRODUKTIVITETIT DUKE RUAJTUR EKSPERTIZËN NJERËZORE

Iris Shehaj*

**Shkolla e Avokatisë së Shqipërisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë*

Përmbledhje

Revolucioni industrial shënoi një ndryshim thelbësor në histori, pasi puna fizike u automatizua gjithnjë e më shumë, duke çuar në zëvendësimin e fuqisë së muskujve me makineri. Megjithatë, në epokën bashkëkohore, një revolucion i ri është duke u zhvilluar – revolucion i fuqizuar nga IA – i cili po transformon natyrën e punës duke automatizuar detyrat mendore. Nga të qenit thjeshtë një fanta-shkencë në të kaluarën, ajo tani është kthyer në një praktikë reale, duke luajtur një rol të rëndësishëm në fushën e ligjit.

Ky punim do të trajtojë mënyrën se si praktikuesit e ligjit, kryejnë kërkime, menaxhojnë dokumentat, realizojnë mbrojtjen dhe madje edhe mënyrën se si bëhen gjykimet në sallën e gjyqit. Procesi i kërkimit kaloi nëpër tre faza të cilat përfshijnë mbledhjen e të dhënave, analizën e gjetjeve kryesore dhe përpunimin duke përdorur një metodologji kërkimore cilësore, që përfshijnë shqyrtimin e literaturës, studimin e rasteve nga praktika dhe synon të paraqes mundësitë e reja që ofron IA.

Megjithatë aplikimi i IA paraqet dhe sfida të reja si paragjykimet algoritmike, gabueshmëria e sistemeve të IA, cenimi i të dhënave personale dhe nevoja për korniza të reja rregullatore. Pyetjet rreth llogaridhënies, përgjegjësisë ligjore dhe se teknologjia e IA mund të zëvendësojë avokatët njerëzorë dhe të minojë ekspertizën dhe gjykimin që praktikuesit e ligjit sjellin në punën e tyre po nxisin debate intensive. Me zhvillimin e inteligjencës artificiale në rritje, ky punim ka si qëllim të shpjegojë më tej se çfarë është inteligjenca artificiale dhe si po përdoret aktualisht në fushën ligjore.

Fjalë çelës: *Inteligjenca artificiale (IA), teknologjia ligjore, profesioni ligjor, gjyqtarë robotë, praktika ligjore, paragjykim algoritmik*

ARTIFICIAL INTELLIGENCE ASSISTANTS IN LEGAL PRACTICE: ENHANCING PRODUCTIVITY WHILE PRESERVING HUMAN EXPERTISE

Abstract

The industrial revolution marked a fundamental change in history as physical work became increasingly automated, leading to the replacement of muscle power by machines. However, in the modern era, a new revolution is underway—the AI-powered revolution—which is transforming the nature of

work by automating mental tasks. From being mere science fiction in the past, it has now become a real practice, playing an important role in the field of law. This paper will address how legal practitioners conduct research, manage documents, conduct defense, and even how trials are conducted in the courtroom. The research process went through three phases, which included data collection, analysis of the main findings and elaboration using a qualitative research methodology, which includes literature review, case studies from practice, and aims to present the new opportunities that AI offers. However, the application of AI also presents new challenges such as algorithmic biases, the fallibility of AI systems, the violation of personal data, and the need for new regulatory frameworks. Questions about accountability, legal liability, and whether AI technology could replace human lawyers and undermine the expertise and judgment that legal professionals bring to their work are causing an intense debate. With the development of artificial intelligence on the rise, this paper aims to further explain what artificial intelligence is and how it is currently being used in the legal field.

Keywords: *Artificial Intelligence (AI), legal technology, legal professions, robot judges, legal practice, algorithmic biases*

Hyrje

Hapësira ligjore është gjithmonë në zhvillim dhe në përpjekje për të evoluar me shoqërinë. Në epokën e IA dhe me zhvillimet e reja teknologjike, IA po transformon dhe po përparon gjithnjë dhe më shumë sektorin ligjor. Ky transformim shikohet që nga puna e përditshme e avokatëve deri te sistemet gjyqësore. Që do të thotë që teknologjitë e inteligjencës artificiale po ndikojnë në aspekte të ndryshme që ofrohen nga shërbimet ligjore duke përfshirë analizën e dokumentave, menaxhimin e kontratave, kërkimin ligjor, praktikave ligjore deri te rezultatet e procesit gjyqësor dhe përcaktimin e dënimeve.

Dhënia e vendimeve të formës së prerë nga “gjyqtarët robotë” kanë filluar të kryhen tashmë në shtete si Estonia dhe Kina. Futja e teknologjisë IA ka potencialin të përmirësojë ofrimin e shërbimeve ligjore, duke i bërë ato më të aksesueshme, efikase dhe me kosto efektive.

Në një raport të publikuar në 2023 nga Goldman Sachs, vlerësoi se 44% e punës ligjore mund të automatizohet nga mjetet e reja të IA. Në qershor të vitit 2023, kishim pikërisht një rast të përdorimit të IA nga një avokat i cili kishte përdorur ChatGPT për të përgatitur një dosje i cili u evidentua nga fakti që roboti i inteligjencës artificiale kishte dorëzuar çështje të rreme.

Edhe pse aplikimi i kësaj teknologjike në sektorin ligjor është kryesisht i kufizuar, teknologjia e inteligjencës artificiale pritet ta ndryshoj këtë duke sjell sfida dhe mundësi të reja. Kjo nuk nënkupton që IA eliminon nevojën për avokatë por ndryshon mënyrën sesi ata mund të kontribuojnë në procesin ligjor.

Ky punim shkencor, ka për qëllim të trajtoj ndikimin që IA ka në sektorin ligjorë duke u ndaluar më specifikisht te avokatet IA dhe gjyqtarët IA. Si mund të ndikoj IA në ngarkesën e përditshme të avokatëve apo aksesueshmërinë e gjykatave? Deri në çfarë mase aplikimi i IA në shërbimet ligjore janë të besueshme dhe të përgjegjshme? Si mund të arrihet një ekuilibër midis inteligjencës artificiale dhe profesionit ligjor për të përmirësuar dhënien e drejtësisë?

Çfarë është Inteligjenca Artificiale?

Koncepti i inteligjencës artificiale u shfaq për herë të parë në vitin 1945, kur Vannevar Bush, një nga themeluesit e hershëm, propozoi një sistem për të përmirësuar njohuritë dhe logjikën njerëzore. Ai u pasua nga Alan Turing, i cili shkroi një artikull në vitin 1950 në lidhje me aftësinë e makinerive për të simuluar njerëzit dhe për të kryer veprime inteligjente si të luaj shah. Megjithatë, përkufizimi klasik

i IA daton që nga viti 1955, kur John McCarthy dhe kolegët e tij e përshkruan inteligjencën artificiale si: “duke e bërë një makineri të sillet në mënyra që do të quheshin inteligjente nëse një njeri do të sillej ashtu” (Antebi, 2021, f.31). Ka shumë përkufizime për IA, por ka dy veçori kryesore që gjenden në shumicën e përkufizimeve: 1) aftësia për të zgjidhur detyra jashtëzakonisht komplekse dhe 2) përshtatja mjedisore (LÜCK, 2019, f.2). Me inteligjencë artificiale nënkuptojmë një sistem të bazuar në makineri që imiton aftësinë njohëse të njeriut duke i dhënë objektiva të qarta ose të nënkuptuara dhe nxjerr përfundime nga të dhënat që merr.

Sipas një përkufizimi specifik të IA në një rekomandim të Këshillit për Inteligjencën Artificiale të OECD-së: *“Një sistem IA është një sistem i bazuar në makineri që mundet, për një grup të caktuar objektivash të përcaktuara nga njeriu, të bëjë parashikime, rekomandime ose vendime që ndikojnë në mjedise reale ose virtuale. Sistemet IA janë dizenuar për të funksionuar/ operuar me nivele të ndryshme autonomie.”* Përkufizimi i inteligjencës artificiale sipas Aktit të IA (AI Act) përkufizohet si: *“një sistem i bazuar në makineri që, për objektiva të qarta ose të nënkuptuara, nxjerr përfundimin, nga inputet që merr, se si të gjenerohen rezultate të tilla si parashikime, përmbajtje, rekomandime ose vendime që mund të ndikojnë në mjediset fizike ose virtuale.*

Inteligjenca artificiale dhe avokatët

Inteligjenca artificiale në praktikën ligjore do të kuptohet si përdorimi i teknologjisë për të kryer detyra që normalisht do të kërkonin profesionistë ligjorë për të kryer punën. Teknologjitë e inteligjencës artificiale, të tilla si algoritmet e mësimi të makinerive (machine learning algorithms), përpunimi i gjuhës natyrore (natural language processing) dhe vizioni llogaritës (compute vision), kanë përdorime të shumta në profesionet ligjore.

Sipas Raportit të Teknologjisë Ligjore të ABA, në sondazhin e vitit 2023, mbi gjysma e avokatëve (58%) u përgjigjën se nuk ishin në dijeni të interesit për mjetet a bazuara në IA ose nuk dinin shumë për IA. Megjithatë rezultatet e sondazhit të 2023 janë të krahasueshme me rezultatet e sondazhit të vitit 2022, ku 57.8% e të anketuarëve raportuan mungesë njohurish. Në vitin 2022, rreth 15% e firmave të vogla dhe vetëm 3.7% e avokatëve ishin duke e përdorur ose të interesuar për mjetet e IA. Në të kundërt në vitin 2023, 20.7% e firmave të vogla dhe 15.6% e avokatëve treguan interes për këto mjete. Interesi në rritje për mjetet e IA mund të jetë për shkak të perceptimit se ato po pranohen më gjerësisht.

Anketat e Teknologjisë 2022 dhe 2023 pyetën të dyja se kur inteligjenca artificiale do të bëhej e zakonshme në fushën ligjore. Në vitin 2022, rreth gjashtë përqind besonin se IA ishte tashmë e zakonshme, ndërsa njëzet përqind mendonin se do të ishte brenda tre viteve. Në vitin 2023, rreth katër përqind e konsideronin inteligjencën artificiale të zakonshme, por thuajse dyzet përqind e të anketuarëve mendonin se do të ishte brenda tre viteve (Wynon, 2023).

Mjetet dhe softuerët e IA që përdoren nga avokatët

Mjetet e asistentëve ligjorë të IA janë programe softuerike që përdorin teknologjinë e inteligjencës artificiale për të ndihmuar profesionistët ligjorë në thjeshtimin e punës së tyre të përditshme.

Prime GPT dhe Primsol GPT: janë krijuar që avokatët të realizojnë më shumë punë brenda më pak kohe. Këto mjete u krijuan dhe u përfshinë në softuerin Lawpavillion për të ndihmuar në kërkimin dhe hartimin ligjor.

EverLaw: EverLaw është një softuer teknologjik ligjor për firmat ligjore, korporatat dhe agjencitë qeveritare që ofron mjete për shqyrtimin e dokumentave, analizën e çështjeve gjyqësore dhe për të ndihmuar profesionistët ligjorë të menaxhojnë vëllime të mëdha të dhënash për të zvogëluar procesin

ligjor.

Lexdoks: Platforma e parë dhe e vetme në Kosovë që lehtëson dhe ndihmon praktikuesit e ligjit në punën e tyre.

Mjete të tjera të IA për avokatët: Click up, Lawgeex, Amto, Dentagle.ai, Ansarada, Lex Machina, Latch, AI lawyer, PatentPal, Humata AI, Casetext, ChatGPT, Relativity, Smith.ai, HarveyAI, Co-Counsel, Blue J L & E, Diligen, Auto-GPT, Gideon, ROSS Intelligence, FaXiaotao, Xiao Fa, Lexzur.

Disa udhëzime të CCBE theksojnë nevojën që avokatët të përdorin me vetëdije dhe me përgjegjësi këto teknologji të reja, në mënyrë që të kryejnë aktivitetet e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme, duke mbrojtur marrëdhënien e besimit midis avokatit dhe klientit. (Avokatia, Nr.34, 2022, f.18)

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në praktikën ligjore

Profesioni ligjor, ashtu si profesionet e tjera, po transformon mënyrën se si kryhet puna ligjore. Ndërsa teknologjia përparon, avokatët po përdorin gjithnjë e më shumë IA për të rritur produktivitetin dhe efikasitetin e tyre (Kalendzhian, 2021, f.35). Këto mjete të reja teknologjike janë hapi tjetër në praktikën ligjore dhe nuk zëvendësojnë rolin unik që luajnë avokatët në ofrimin e këshillave ligjore.

Një avokat që përdor inteligjencën artificiale do të duhet ende të zbatojë gjykimin e tij racional për të vlerësuar vlefshmërinë e fakteve të supozuara dhe përshtatshmërinë e teknologjisë në zgjidhjen e konfliktit ligjor. Ky gjykim racional aktualisht është përtej aftësive të inteligjencës artificiale, qoftë përmes përpunimit të gjuhës natyrore apo mësimit të makinerive (Alarie, et al., 2018, 120). Avokatët shkojnë përtej përgjigjes së pyetjeve ligjore, ata zotërojnë aftësi për të këshilluar klientët duke marrë parasysh rrethanat e klientit, si dhe zgjidhje kreative ndërsa IA mund të ndihmojë në analizën e të dhënave.

John McGinnis dhe Russell Pearce kanë argumentuar se inteligjenca e makinerive do të krijojë një ndikim të rëndësishëm në tregun e shërbimeve ligjore, veçanërisht në fusha të tilla si zbulimi, kërkimi ligjor, gjenerimi i dokumentave dhe parashikimi i rezultateve të çështjes (Alarie, et al, 2018, f.108).

Fushat kryesore të teknologjisë ligjore:

Teknologjia ligjore, është një term që përdoret për të përshkruar përdorimin e teknologjisë dhe zgjidhjeve softuerike brenda fushës ligjore për të përmirësuar dhe thjeshtuar procese të ndryshme ligjore

- | | |
|---------------------------------|---------------------------------|
| 1. Hulumtimi Ligjor | 7. Menaxhimi i çështjeve |
| 2. E-discovery | 8. Këshillim Ligjor |
| 3. Analizë të kontratave | 9. Menaxhimi i detyrave |
| 4. Automatizimi i dokumentave | 10. Hartimi ligjor |
| 5. Analiza ligjore parashikuese | 11. Analiza e çështjeve ligjore |
| 6. Rishikimi ligjor | 12. Due diligence |

Megjithatë, IA përballlet me sfida të tilla si konsiderata etike që kanë potencialin për paragjykim algoritmik, të cilat mund të ndodhin si rezultat i vendimeve të mëparshme të njëanshme të gjykatës ose sistemit të njëanshëm të IA. Gjithashtu të dhënat ose baza ligjore që mund të jenë të pasakta duke rezultuar në një dokument ligjor të pavlefshëm, ose sistem i IA që menaxhon të dhëna sensitive ligjore mund të cenojnë privatësinë e individit dhe të drejtat e mbrojtjes së të dhënave personale. Objekt cen-

imi është edhe e drejta për gjykim të drejtë e cila mund të cenohet për shkak të mungesës së transparencës mbi mënyrën e funksionimit të IA-së. Praktikisht të gjitha të drejtat e njeriut mund të preken nga përdorimi i sistemeve të IA-së. Problemi me këto sfida sillet rreth përcaktimit të përgjegjësisë ligjore. A do të mbahet përgjegjës IA? A mund të japë shpjegim IA për veprimet dhe vendimet e saj? Në këtë drejtim, çështjet në lidhje me barrën e provës, përgjegjësinë strikte dhe besueshmërinë e produktit do të duhet të rishqyrtohen në një masë të caktuar. (Avokatia, Nr.34, 2022, f.17)

Përdorimi i IA në sistemin gjyqësor: Analizë krahasimore

Imagjinojeni veten në një sallë gjyqi, ku në vend të gjyqtarit, përballë jush është një kompjuter i cili vlerëson provat tuaja dhe merr vendime. Kjo mund të duket e pabesueshme, por në shumë shtete tashmë është kthyer në realitet. Kjo çështje është debatuar gjerësisht në shtete të ndryshme si Estonia, Australia, Kina, ShBA, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Letonia, Holanda, Austria, Kanadaja, etj, me dy pikëpamje të kundërta, avantazhe dhe disavantazhe, lidhur me përdorimin e sistemeve IA në sallën e gjyqit. Këto ndryshime ngrenë pikëpyetje lidhur me rolin e gjykatave dhe gjyqtarëve në të ardhmen, si dhe sfida mbi menaxhimin e të dhënave, kategorizimin, si dhe për ndarjen e funksioneve ekzekutive dhe gjyqësore.

Në vitin 2013, drejtësia parashikuese u aplikua në çështjen Shteti k. Loomis, ku ndaj një shtetasi amerikan rëndonin akuza si përfshirja në të shtëna nga makina, posedimi i sendeve të vjedhura, dhe rezistenca ndaj arrestit. Një program parashikues asistoi gjykatën e qarkut për të caktuar një dënim me burgim për shkak të probabilitetit të lartë të recidivizmit të të pandehurit. Gjykata Supreme e Uiskonsin konfirmoi legjitimitetin e softuerit, duke u shprehur se gjyqtari do të kishte marrë të njëjtin vendim pavarësisht programit. Programe AI si COMPAS (Profilizimi i Menaxhimit Riedukues të Shkelësve për Dënime Alternative) ndihmojnë gjyqtarët për të vlerësuar faktorë rreziku si e shkuara kriminale, rrethanat shoqërore dhe shëndeti mendor për të parashikuar recidivizmin. COMPAS është përdorur nga shtetet amerikane të Nju Jork, Uiskonsin, Kaliforni, konteja Brouard në Florida, dhe juridiksione të tjera (Kirkpatrick, 2017, f.21). Komisioni Amerikan i Caktimit të Dënimit e shfrytëzon IA për të krijuar dhe zbatuar udhëzime të drejta për caktimin e dënimit. Në vitin 2019, Ministria e Drejtësisë e Estonisë, me kryespecialistin e të dhënave Ott Velsberg, krijuan një softuer AI pilot për zgjidhjen e padive me vlerë të vogël nën 7.000 Euro (Park, 2020, f.47). Softueri përqëndrohet te mosmarrëveshjet kontraktore, duke përdorur një algoritëm për të marrë vendime paraprake bazuar në dokumentet e ngarkuara që mund të rishikohen nga një gjyqtar njeri (Crotoft, 2019, f.233).

“Gjykata e zgjuar” e Kinës përdoret si një strukturë ligjore ku nëpunësit gjyqësorë përdorin teknologjinë për të rritur performancën e tyre dhe për t’i ofruar publikut shërbime gjyqësore të përmirësuara. Ajo mund të jetë një gjykatë fizike apo virtuale ku procedurat gjyqësore kryhen në mënyrë digjitale. “Vendimet Online të Kinës”, e mbështetur nga Gjykata Supreme Popullore, mundëson koleksionin më të madh të vendimeve përfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatave kineze. Po në vitin 2019, një gjykatë në Hangzhou, në jug të Shanghait, përdori inteligjencën artificiale. Programi asistent i gjyqtarit, Xiao Zhi 3.0, ndihmoi në një gjyq të 10 personave që nuk kishin paguar kreditë bankare. Më përpara, zgjidhja e çështjeve të tilla do të kërkonte 10 gjyqe të ndara, por nëpërmjet Xiao Zhi 3.0, të gjitha çështjet u adresuan në një seancë me një gjyqtar, duke dhënë një vendim brenda 30 minutave.

Në Kanada, aplikacioni i negocimit “Smartsettle ONE” zgjidhi me sukses një mosmarrëveshje tre-mujore për tarifa të papaguara në më pak se një orë.

Në Europë, Komisioni European për Eficencën në Drejtësi (CEPEJ) ndërmori një hap të rëndësishëm drejt inovacionit digjital në sistemet gjyqësore duke krijuar “Kartën Europiane të Etikës mbi përdorimin e inteligjencës artificiale në sistemet gjyqësore dhe mjedisin e tyre”. Kjo Kartë ka për qëllim të sigurojë që programet AI/ML në sistemet gjyqësore të respektojnë të drejtat themelore, përfshirë ato në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe në Konventën për Mbrojtjen e Individëve lidhur

me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale. Plani i Veprimit 2022-2025 i CEPEJ “Digjitalizimi për një drejtësi më të mirë” përcakton një rrugë me tre hapa drejt përdorimit të drejtë të IA në gjykata (Giarda, et al, 2022)

Çfarë mund të bëjë inteligjenca artificiale për gjykatat?

1. Organizimi i informacionit;
2. Këshillimi;
3. Parashikimi;

Pavarësisht dobive të IA për kursimin e kohës, parave, dhe përmirësimit të aksesueshmërisë në drejtësi, ngrihen probleme lidhur me çështje si paanshmëria, paragjykimi, transparenca, llogaridhënia, dhe privatësia.

Integrimi i inteligjencës artificiale në kuadrin ligjor shqiptar:

Mundësitë, sfidat dhe konsideratat ligjore

Shqipëria, ashtu si dhe shtetet e tjera ka pasur një qasje pozitive ndaj Inteligjencës Artificiale duke miratuar edhe ligjin për qeverisjen elektronike. Sektori publik dhe privat ka realizuar shumë përparësi për sa i përket teknologjisë lidhur dhe me krijimin dhe përdorimin e një asistenti virtual në e-albania apo në shërbime të tjera publike. Në ligjin Nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, përcaktohet se: *“Inteligjenca artificiale” është simulimi i proceseve të inteligjencës njerëzore nëpërmjet sistemeve dhe algoritmeve kompjuterike* dhe në nenin 39 shprehet se: *“Teknologjia e inteligjencës artificiale aplikohet, aty ku është e mundur, në sistemet elektronike të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit me qëllim rritjen dhe inovacionin në ekonominë digjitale”*.

Por nga ana tjetër në sektorin ligjor shqiptarë ka pasur shumë pak risi për sa i përket përdorimit të teknologjisë në praktikën ligjore dhe nuk ka parashikime ligjore për përdorimin e saj por kjo ka prirje të ndryshoj duke marrë parasysh përdorimin e inteligjencës artificiale dhe drejtimin e saj drejt një drejtësie elektronike.

Sipas nenit 3 të Ligj Nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”: *“Profesioni i avokatit udhëhiqet nga parimet bazë të profesionalizmit, etikës, besnikërisë, integritetit dhe konfidencialitetit”*. Këto parime bazë të parashikuar nga neni 3 mund të shkelen me përdorimin e inteligjencës artificiale në kryerjen e detyrave të një avokati. Parimi i konfidencialitetit i parashikuar dhe në nenin 10 të po këtij ligji parashikon detyrën e avokatit për ruajtjen e sekretit profesional dhe konfidencialitetin e të dhënave, për të cilat është vënë në dijeni nga klienti ose nga dokumentet, që ky i fundit i ka vënë në dispozicion, në funksion të mbrojtjes së kërkuar, me përjashtim të rastit kur klienti ka dhënë miratim me shkrim. Megjithatë mjetet e inteligjencës artificiale mund të ngrenë shqetësime për shkeljen e konfidencialitetit si përsëmbull shkelje të sigurisë së të dhënave duke përbërë rrezik për akses të paautorizuar në informacione sensitive, përgjimin e të dhënave nëse serverët e IA komunikojnë me server të jashtëm përmes kanaleve të pasigurta duke rënë ndesh dhe me parimin e etikës së një avokati. Sigurisht që çënimi i këtyre të drejtave të klientit mund të mbrohen në Shqipëri, nga ligji nr.25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike” ose mbrojtja e të dhënave nga Ligji Nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar. Nëqoftëse këto të dhëna përdoren për arsye kriminale do të dënohen sipas parashikimeve të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Një nga problematikat e tjera të përmendura në punim është dhe çështja e përgjegjësisë. Në nenin 8 pika f të ligjit “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë” është përcaktuar detyra e avokatit për marrjen e masave të nevojshme në lidhje me sigurimin e përgjegjësisë profesionale, nëqoftëse këto detyra do të realizohen nga inteligjencia artificiale ngrihen pikëpyetje për përgjegjësinë

profesionale se kush do të ishte përgjegjës avokati apo mjetet e inteligjencës artificiale?

Në nenin 3 pika e dytë e ligjit Nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar parashikohet se: *“Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye”*. Marrja e këtyre vendimeve nëpërmjet inteligjencës artificiale cenojë bindjen e brendshme dhe të lirë të gjyqtarëve, marrë shkas nga kjo në nenin 2 përkufizohet se: *“Dokument ligjor” për qëllim të vlerësimit të aftësive profesionale nënkupton çdo dokument të përgatitur nga personi gjatë ushtrimit të detyrës profesionale, si vendim gjykate, kërkesë për gjykim, raport/relacion, padi, mendim/opinion ligjor, si dhe akte të tjera që provojnë kapacitetet profesionale të personit*. Në përkufizim janë cilësuar dy elemente së pari se këto dokumenta përgatiten nga një person dhe jo nga mjetet e inteligjencës artificiale që e bën të pa zbatueshme përdorimin e inteligjencës artificiale dhe së dyti elementi i vlerësimit të aftësive profesionale. Në nenin 3 të po këtij ligji të sipër cituar parashikohet dhe se: *“Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa para-gjykime”*. Por a mund të realizohet funksioni gjyqësor pa paragjykime kur mjetet e inteligjencës artificiale kanë mundësi për të kryer paragjykime algoritmike? Kjo është një pyetje tjetër që ne duhet ti përgjigjemi por njëkohësisht nëqoftëse aplikohen mjetet e inteligjencës artificiale duhen të ndërmerren masat e duhura për të parandaluar cenimin e të drejtave të individëve në sallën e gjyqit nga një vendim paragjykses.

Nga ana tjetër marrë shkas nga reforma në drejtësi në vitin 2017 dhe numrin e lartë të çështjeve të pazgjdhura në Gjykatën e Lartë, inteligjenca artificiale mund të ndihmojë në uljen e numrit të çështjeve. Gjyqtarët mund të analizojnë, vlerësojnë dhe interpretojnë më lehtë të dhënat duke shkurtuar kështu kohëzgjatjen e zgjidhjeve të çështjeve dhe duke realizuar dhe një ekonomi gjyqësore dhe ulur shpenzimet e proceseve gjyqësore.

Gjithashtu përdorimi i inteligjencës artificiale në organet e drejtësisë shërben si një katalizatorë për të luftuar korrupsionin dhe duke rritur besimin dhe transparencën ndaj publikut. Sistemet e IA mund të ofrojnë nga ana tjetër vendime më etike dhe të paanshme duke zvogëluar rrezikun e korrupsionit që vjen nga veprime korruptive, mendime subjektive ose paragjykesë.

Përfundime

Në përfundim, ky punim ka analizuar ndikimin e inteligjencës artificiale në profesionin ligjor, duke paraqitur ndryshime të rëndësishme në mënyrën se si avokatët dhe gjyqtarët realizojnë detyrat e tyre.

Mjetet e IA rrisin efikasitetin dhe produktivitetin duke automatizuar detyrat e praktikuesve të ligjit dhe shërbejnë për të analizuar, parashikuar vendime, çështje gjyqësore dhe garantimin e dokumentave dhe materialeve kërkimore duke reduktuar punën e përditshme të avokatëve dhe gjyqtarëve.

Megjithatë ka dhe konsiderata etike dhe ligjore që duhen të merren parasysh në përdorimin e inteligjencës artificiale në mënyrë të përgjegjshme dhe transparente. Rastet studimore dhe analizat krahasuese nënvizojnë rëndësinë për rregullime specifike në kuadrin ligjor.

Ndërsa teknologjia e IA vazhdon përparon, ka mundësi që ndikimi i saj në profesionin ligjor vetëm të rritet dhe është e rëndësishme të studiohet dhe monitorohet. Duke arritur një ekuilibër midis zhvillimit teknologjik dhe përdorimit të Inteligjencës Artificiale në praktikën ligjore mund të shfrytëzohet fuqia e IA për të përmirësuar dhënien e drejtësisë në një botë gjithnjë e më digjitale.

Si përfundim, ky punim kontribuon në rritjen e njohurive mbi raportin e inteligjencës artificiale me profesionet ligjore.

Referenca

1. Akti i Inteligjencës Artificiale
2. Alarie, B., Niblett, A., & Yoon, A. H. (2018). How Artificial Intelligence Will Affect the Practice of Law, *The University of Toronto Law Journal*, 68, 106–124. <<https://www.jstor.org/stable/90019655>>
3. Antebi, L. (2021). What is Artificial Intelligence? In *Artificial Intelligence and National Security in Israel*, Institute for National Security Studies. < <http://www.jstor.org/stable/resrep30590.7> >
4. Crootof, R. (2019). “Cyborg Justice” And the Risk of Technological–Legal Lock-In. *Columbia Law Review*, 119(7).
<<https://www.jstor.org/stable/26960742>>
5. Giarda, Ambrosino, “Artificial Intelligence in the administration of justice”, Baker McKenzie’s LegalBytes, 2022
7. Kalendzhian, S. (2021). How Technology is Changing the Nature of Work and Altering the Practice of Law. In S. P. de Souza & M. Spohr (Eds.), *Technology, Innovation and Access to Justice: Dialogues on the Future of Law*, Edinburgh University Press. <<http://www.jstor.org/stable/10.3366/j.ctv1c29sj0.11>>
8. Kirkpatrick, Keith, “It’s not the algorithm, it’s the data”. *Communications of the ACM.*, vol.60, issue.2, 2017
9. <[doi:10.1145/3022181](https://doi.org/10.1145/3022181)>
10. Kite-Jackson, D. W. (n.d.). 2023 Artificial Intelligence (AI) TechReport. <https://www.americanbar.org/groups/law_practice/resources/tech-report/2023/2023-artificial-intelligence-ai-techreport/>
11. Ligj Nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”
12. Ligji Nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”
13. Ligji Nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
14. Ligji Nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar
15. Ligji Nr.25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”
16. LÜCK, N. (2019). Machine Learning-Powered Artificial Intelligence. In *Machine Learning-Powered Artificial Intelligence in Arms Control*, Peace Research Institute Frankfurt. <<http://www.jstor.org/stable/resrep26193.5>>
17. Park, Joshua. “YOUR HONOR, AI.” *Harvard International Review*, vol. 41, no. 2, 2020
18. <<https://www.jstor.org/stable/26917302>>
19. Rekomandimi i Këshillit për Inteligjencën Artificiale të OECD-së
20. Wynon, ABA Legal Technology Report,2023
21. <https://www.americanbar.org/groups/law_practice/resources/tech-report/2023/2023-artificial-intelligence-ai-techreport/>